

MINUTA TË TAKIMIT

Procesi i bashkëkrijimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2026–2030 për Partneritetin për Qeverisjen e Hapur

Data: 24 prill 2026

Ora: 10:00

Vendi: Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural

Më datë 24 prill 2026, në orën 10:00, në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Ministrisë dhe palëve të interesuara, në kuadër të procesit të bashkëkrijimit të Planit Kombëtar të Veprimit 2026–2030 për Partneritetin për Qeverisje të Hapur.

Takimi u hap nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Këshillimor, Transferimit të Teknologjive Bujqësore dhe Zbatimit të Projekteve, z. Ervin Hajdaraga, i cili falënderoi pjesëmarrësit për praninë dhe kontributin e tyre, duke theksuar rëndësinë e dialogut dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm në bazë të mendimeve të mbledhura nga grupet e interesit.

Takimi u zhvillua në kuadër të pyetësorit mbi transparencën e Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi dhe u fokusua në shkëmbimin e mendimeve me palët e interesuara për përmirësimin e proceseve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Gjatë diskutimeve u trajtuan çështje që lidhen me përvojën e aplikuesve, me fokus në transparencën, aksesin në informacion si dhe në ecurinë dhe parashikueshmërinë e procesit të shqyrtimit të aplikimeve, duke u ndalur gjithashtu në rolin e mbështetjes për fermerët dhe në rëndësinë e zbatimit të saj në mënyrë sa më praktike në sektorin bujqësor.

Në përfundim të takimit, pjesëmarrësit dhe përfaqësuesit e Ministrisë vlerësuan se diskutimet mes tyre ishin të frytshme, duke e mbyllur takimin në një frymë pozitive dhe bashkëpunuese.